



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 060/01-17631/20
Kaçanik, 12.08.2020

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VI (Gjashtë)** e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2020 (Legjislatura e VI-të), mbajtur me 12 Gusht 2020. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës, prej 27 anëtarëve të KK, pjesëmarrës në mbledhje fillimisht ishin 22 anëtarë, në ndërkohë erdhi anëtarja Albana Troni, ndërkaq gjatë shqyrtimit të pikës së fundit- pikës së 4-të erdhi anëtarja, Vlora Dalloshi, kështu që pjesëmarrja në pikën e 4 ishin 24 anëtarë. Gjatë tërë mbledhjes munguan me arsye dy anëtarë, Ekrem Kyçyku dhe Kaltrina Tafili, ndërkaq anëtarja Afërdita Shehi ka ofruar dorëheqje, ende nuk kemi ndonjë Vendim nga KQZ për zëvendësimin e saj.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Nënkryetari i Komunës- Ylber Bajra, drejtorët e drejtorive komunale: Bahri Selimi, Ramadush Osmani, Fatmir Loku dhe Diana Reka, ndërkaq nga zyrtarët e komunës: Bejtulla Dalloshi dhe Arbnora Kuka.

Nga KDI, mbledhja u monitorua nga Kijani Sallahu.

Nga niveli qendror, mbledhja monitorohet përmes, Teleprezencës nga Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në MAPL.

Për shkak të pandemisë Covid-19, në sallën e Kuvendit të Komunës janë krijuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes me distancë fizike, pajisje me maska mbrojtëse dhe dezinfektues.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtës, Makfire Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndeti të gjithëve, iu uroj mirëseardhje, kuorumi me u mbajtur mbledhja ekziston, prezentë në mbledhje fillimisht konstatohet së janë 22 anëtarë, 2 anëtare (Albana dhe Vlora nuk kanë lajmëruar, besoj së vijnë në ndërkohë), ndërkaq me arsye mungojnë dy anëtarë, Ekrem Kyçyku dhe Kaltrina Tafili, të cilët më kanë njoftuar me shkrim për mungesën e tyre. Letër mesazhi i dërguar nga Ekrem Kyçyku u lexua nga Kryesuesi i Kuvendit, ku jep arsyet për mungesën e tij dhe për mungesën e Kaltrina Tafili, ndërkaq anëtarja Afërdita Shehi ka ofruar dorëheqje, lënda është dërguar në KQZ, ende nuk kemi ndonjë Vendim nga KQZ për

zëvendësimin e saj. Kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e VI (Gjashtë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2020, data 12 Gusht, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Raporti gjashtëmujor financiar, për periudhën: Janar-Qershor 2020;
3. Raporti i Punës së KKSB – së për 6 mujorin e parë 2020; dhe
4. Propozim Vendimi për pagesën e komisioneve të formuara nga Kuvendi i Komunës.

P.S. Pika e 4 nuk ishte sipas ftesës për mbledhje. Kjo pikë u propozua me hynë në rend pune në mbledhje, ndërsaq materiali për këtë pikë është dërguar 4 ditë para mbledhjes.

Kryesuesi i Kuvendit, Lidhur me rendin e punës e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e propozuar të punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

APROVOJ

Rendin e Punës në përbërje prej 4 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

Kryesuesi i Kuvendit, Procesverbalin e mbledhjes së kaluar të KK e keni marrë, nëse ka kush diçka lë të urdhëroj; Për vërejtje nuk u paraqit kush, atëherë Procesverbalin e mbledhjes së Pestë (V) të Rregullt të Kuvendit të Komunës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

APROVOJ

Procesverbalin nga mbledhja e V-të (Katërt) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2020 të datës 21 Korrik 2020 / Lënda: 01Nr. 60/01-15704/20.

Pyetje dhe Kërkesa

z. Adnan Reka,

1. Kam një kërkesë nga qytetarët, për zhurmën e madhe që kefiteritë shkaktojnë në mbrëmje, ata ankohen nga zhurma tepër e madhe që nuk mund të qëndrojnë edhe nëpër banesat apo shtëpitë e tyre, për çka edhe ne jemi dëshmitarë, kërkojmë të merren masa në këtë drejtim.
2. Pyetje për DSHPE, Drejtor! A jeni ne dijeni së asnjë ujëmbledhës i reshjeve atmosferike nuk është funksional në rrugën e sapo ndërtuar nga ndërtesa e Postës deri të Ura e Konakut, këtë më së miri e dëshmoi shiu që ra para kësaj jave, për dy ditë me radhë ujërat atmosferik

vazhduan të rrjedhin si përrua përmes rrugës dhe si pasojë kemi gërryerje të kubzave dhe deformim të kësaj rruge të sapo rinovuar.

3. Për kundër përgjigjeve tuaja me shumë politike sesa përmbajtjesore, rruga nga Shtëpia e Kulturës deri të Xhamia e Dëshmorëve në të dyja anët e lumit është e pa ndriçuar, sigurisht ju po e bëni me qëllim për të kursyer buxhetin, por në anën tjetër ju po e instaloni terrin në Komunën tonë, shumë keq!

z. Selim Reka, A është marrë ndonjë veprim nga Drejtoria e Arsimit për përgatitjen e hapësirave shkollore për fillimin e vitit të Ri shkollor 2020/2021 ?

znj. Nazife Krasniqi, Kam një kërkesë nga banorët e lagjes “ Hasan Prishtina” lidhur me mungesën e ndriçimit publik në atë rrugë. Ndriçimi publik në atë rrugë duhet të realizohet, sepse është nevojë dhe kujtoj së kushton shumë realizimi i këtij projekti. Gjithashtu është e nevojshme në atë rrugë të vendoset një barrierë për ndalimin e shpejtësisë, për shkak së kjo rrugë është shumë e frekuentuar.

z. Bekim Koxha, Pyetje për drejtorin e DSHPE, Pse mërgimtarët duhet të paguajnë mbeturinat 20 €, kur dihet se ata nuk qëndrojnë këtu.

z. Agim Mani, Kam një Kërkesë nga lagjet; Mani, Teneqja dhe Dashi të f. Stagovë, lidhur me problemet të cilat i kanë me energjinë elektrike si pasojë e rrymës së dobët. Rryma e dobët në këto lagje ua vështirëson jetën qytetarëve, me çka po iu shkaktohen defekte e prishje të pajisjeve elektrike. Kërkesa e banorëve të këtyre lagjeve është bërë qysh herët, mirëpo e njëjta nuk është shqyrtuar. Ndërtimi i një trafo elektrike për ato lagje, do të ndihmojë qytetarëve të komunës me pasur energji elektrike të mjaftueshme për funksionim më të mirë të jetës së qytetarëve të atyre lagjeve. Unë kërkoj nga Kryetari i Komunës që të shfrytëzojë autoritetin e tij tek organi përkatës për ndërtimin e një trafo elektrike në f. Stagovë.

z. Besim Vishi, Kam një kërkesë për DSHPE për vendosjen e pengesave në rrugë të shtylla dhe të punëtorit në afërsi të shkollës fillore në f. Dubravë,. Pengesat mos të bëhen të plastikës , por të jenë me të buta dhe të papërshtatshme. Të energjia elektrike që u potencua së është e dobët në disa fshatra të lagjes Stagovë, projekti ekziston, por nuk është realizuar.

Kryesuesi i Kuvendit, Lidhur me Kërkesat e ngritura, besoj se drejtorët e drejtorive kanë marrë shënime lidhur me kërkesat e ngritura dhe do të japin përgjigjet me shkrim ashtu siç jemi kuptuar. Atëherë kalojmë në pikët e tjera sipas radhës:

2. Raporti gjashtëmuor financiar për periudhën: Janar – Qershor 2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Adnan Reka, Raporti si dokument mendoj së është i përpiluar mirë, por menaxhimi i buxhetit mendoj së nuk është i mirë, për faktin së: Kur jemi te implementimi i përgjithshëm i buxhetit (tabela 1) kemi një realizim vetëm prej 35.74% të buxhetit, ndërsa kur jemi tek të hyrat vetanake kemi realizim vetëm për 7.53 % që është tepër pak. Ndërsa kur jemi te Inkasimet nga të HVK (tabela 2) kemi një inkasim total vetëm për 33.75 %, ndërsa këtu kemi Bujqësinë dhe Pylltarinë që për 6 muaj inkason vetëm 2, 61% që serish është tepër pak. Në anën tjetër kur jemi të shpenzimet (tabela 3) ne kategorinë Investime Kapitale kemi vetëm

12.78 % te shpenzuara apo 30.27 % me pak se vitin e kaluar. Në kategorinë Subvencione dhe Transfere kemi vetëm 10.09 % te shpenzuara apo 62.07 % me pak së vitin e kaluar. Ndërsa të kategoria Shpenzime Komunale kemi 27.15 % apo 27.01 % me pak së vitin e kaluar. Ndërsa si rrjedhojë e menaxhimit jo të mirë, si çdo herë nga Mallrat dhe Shërbimet duhet te paguajmë edhe shpenzimet e vendime te gjykatave për 53.000 euro. Dhe, i gjithë ky menaxhim jo i mirë i buxhetit mundohet të arsyetohet përmes COVID-in 19, por Jo, COVID-i nuk i ka fajet për gjithçka

z. Selim Reka, Nga raporti financiar shihet së, dallime të mëdha të implementimi i buxhetit, si të granti i shëndetësisë ashtu edhe të granti i arsimit. Të HVK të Tatimi në pronë, janë 42.13 % , e që në raport me vitin e kaluar shihet së kemi ulje të inkasimit të mjeteve në këtë program buxhetor. Ngecje të inkasimit të mjeteve buxhetore kemi të, rexhistrimi i auto veturave, ndërkaq të taksat nga ushtrimi i veprimtarisë është një ngritje e vogël. Ulje të inkasimit ka të gjobat nga inspektorati, taksat tjera, ndërkaq nuk kemi të hyra nga licencat për pranim teknik të lokalit. Të shpenzimet e realizuara, shqetësuese janë; subvencionet dhe transferet të cilat shpenzime janë realizuar në shumë të vogël, ndërkaq dihen nevojat e qytetarëve të komunës për subvencione. Gjithashtu shpenzimet të Investimet kapitale janë të vogla. Për kundër arsyeve të pandemisë, procedurave etj. shpresoj që këto shpenzime të rriten në muajt e mbetur të këtij viti, në mënyrë që mos të ngelin në suficit buxhetor. Të shpenzimet komunale, nga raporti shihet së ka rritje të shpenzimeve të mbeturinat dhe të energjia elektrike. Gjithashtu rritje të shpenzimeve kemi të mallrat dhe shërbimet, sigurisht kjo për shkak të ndarjes së mjeteve buxhetore për menaxhimin e pandemisë.

z. Ekrem Raka, Nga Raporti shihet se fondi i investimeve kapitale për 6 muaj është realizuar në përqindje shumë të vogël. Pyetje ime është: A ka gjasa me u realizuar ky fond në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2020, në mënyrë që mos të ngelin mjete të këtij fondi në suficit buxhetor ?

z. Bahri Selimi-Drejtor i DEFZH, Kur jemi të realizimi i buxhetit 2020, buxheti është realizuar 36.08%, e që në krahasim me vitin e kaluar kemi shkallën e shpenzimit për 6% progres. Të MSH ka rritje të shpenzimeve për shkak të lejimit të mjeteve buxhetore-fondit emergjent për parandalimin e pandemisë Covid-19 si dhe ekzekutimin e vendimeve të gjykatave nga kjo kategori ekonomike. Të Vendimet e gjykatave, kemi mjete të marra nga MSH që janë borgje të vitit të kaluar. Disa konteste janë edhe të DAK që na i kanë marrë mjetet me përmbarues privat. Të Investimet kapitale të tabela analitike janë të dhënat ku janë tërhequr mjetet për lëndë përmbarimore. Në raport është potencuar se nga janë tërhequr mjetet për lëndë përmbarimore, si nga projektet e turizmit, pastaj nga projekti "Rindërtimi i projektit të QMF në Doganaj" shuma 30.000€. Shuma 53.000€ janë obligime e gjykatave të cilat janë marrë në secilën drejtori. Të shpenzimet komunale është një rritje e lehtë, për shkak të shtimit të numrit të faturave të energjisë elektrike për ndriçim publik si dhe realizimin e pagesave të faturave të papaguara të vitit të kaluar. Të kategoria e Investimeve kapitale kemi shpenzim më të ulët të mjeteve buxhetore, për arsye të pagesave për iniciimin e procedurave të prokurimit dhe mungesës së alokimit të mjeteve buxhetore nga niveli qendror për shkak të pandemisë Covid-19.. Të Subvencionet dhe transferet, ka rënie të shpenzimeve për disa aktivitete të rregullta kulturore e sportive të cilat nuk janë zhvilluar. Për shkak të pandemisë Covid-19, buxhetin e kanë zvogëluar edhe, mos ndalja e kamatave, mos shqiptimi i dënimeve dhe mungesave e mërgimtarëve.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë konstatoj së Kuvendi i Komunës u,

Njoftua

Me Raportin gjashtëmuor financiar për periudhën: Janar – Qershor 2020 / Lënda: 01Nr. 05-400/01-17237/20.

3. Raporti i Punës së KKSB për 6 muorin e parë 2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka në këtë raport, e hapi diskutimin:

z. Selim Reka, Kërkoj nga Kryetari i Komunës që të inicioj në KKSB çështjen e parkimit të auto veturave nëpër rrugë e trotuare, sepse këto parkime po vështirësojnë kalimin e lirë të qytetarëve. Nëse nuk merren veprime me herët me i ndalë këto parkime, atëherë në sezonin e dimrit qarkullimi i lirë i qytetarëve nga parkimet e tilla të auto veturave do të vështirësohej edhe më tepër.

Policia e Kosovës dhe Inspektorët duhet me dalë më shumë në inspektime nëpër lokale, sepse shumë pak po aplikohen vendosja e maskave, dezinfektues etj. me çka mund të rrezikojnë më infektimin e qytetarëve me Covid-19. Këto dy organe munden me marrë veprime që me u bërë diçka më tepër në këtë drejtim.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, Raporti i KKSB sipas Udhëzimit Administrativ në fuqi, kalon si informatë, kështu që konstatoj se Kuvendi i Komunës u,

Njoftua

Me Raportin e Punës së KKSB për 6 muorin e parë 2020 / Lënda: 01Nr. 60/01-16789/20.

4. Propozim Vendimi për pagesën e komisioneve të formuara nga Kuvendi i Komunës.;

Kryesuesi i Kuvendit, Kompensimi i komisioneve ka qenë kërkesë e kahershme e KK dhe shumë e diskutueshme edhe në shumë takime të tjera, kështu që Kryetari i Komunës ka dalë më Propozim Vendim për Pagesën e Komisioneve. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

znj. Arlinda Rakoci-Raka, Në këtë Propozim Vendim, unë nuk e shoh së është përfshirë, Komisioni për përzgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara. Ne si komision kemi punuar dy ditë e më tepër radhazi në këtë komision.

Kryesuesi i Kuvendit, Propozuesi i vendimit e ka paraparë për kompensimin për komisionet funksionale, por jo edhe ato edhe komisionet ad hoc.

z. Nexhat Loku, Kërkesa për kompensimin e komisioneve të KK është e kahershme. Ne e kemi shqyrtuar si GP i PDK Propozim Vendimin e Kryetarit të Komunës, dhe kemi dalë me disa kërkesa për plotësimin e këtij propozim vendimi, sidomos të pika 4, ku bëhet fjalë që të paguhet komisionet me ½ e shumë së komiteteve të rregullta, që i bien 25 €, propozoj që pagesa me qenë 50 €, sikurse komitete e rregullta.

Të pika 2, Kompensimi me qenë për anëtarët e jashtëm dhe për anëtarët e Kuvendit të Komunës, ndërkaj anëtarët nga Ekzekutivi i Komunës nuk kompensohen.

3. Kërkojmë që të mbulohen me pagesë të gjitha komisionet e Kuvendit të Komunës të kësaj legjislature nga themelimi i këtij kuvendi.

z. Ekrem Raka, Si Propozim Vendim është jo i plotë për shkak së nuk është përfshirë kompensimin i të gjitha komisioneve të formuara nga KK, qoftë të rregullta apo ato ad hoc. Kërkesa ime është që, këtij Propozim Vendimi t'i shtohet edhe një pikë, ku përcakton kompensimin e të gjitha komisioneve që janë formuar deri me tani dhe ato që do t'formohen pas marrjes së këtij vendimi.

Kryesuesi i Kuvendit, Mirë që është marrë një hapë me zgjidhur këtë çështje, edhe pse nuk e dimë sesi do të përfundoj, sepse vendimi shkon në qeveri për shqyrtim të ligjshmërisë së tij. Plotësimet e Propozim Vendimit që po kërkohen janë me vend, lënda është përgatitur shpejt dhe e njëjta është dërguar me vonesë anëtarëve të KK. Ky është një hap i mirë që po merret, sepse komuna hasë në probleme të funksionimit nëse ne nuk mund t'i formojmë komisionet, sepse secili anëtarë i KK heziton me qenë në komision pa kompensim. Të çështja e pagesës, kjo është në rregull, shuma 25€ zëvendësohet me 50€ pasi numri i mbledhjeve maksimumi është 6 mbledhje me kompensim. Kompensimi iu bëhet anëtarëve të jashtëm të komisionit dhe anëtarëve të komisionit nga KK, kjo ka logjikë, sepse anëtarët e KK nuk kanë pagë, por kompensime dhe paushall. Të kompensimet e komisioneve që janë formuar më herët, është mirë të bëhet pagesa e të gjitha komisioneve që kanë qenë funksionale. Kërkesa e Ekrem Raka, që të kompensohen edhe komisionet që formohen pas marrjes së këtij vendimi, nëse ky vendim kalon në MAPL, atëherë për secilin komision që e formojmë, në vendim e potencojmë çështjen e kompensimit. Të çështja e komisionit për emërimin e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara, është një komitet i cili kompensohet dhe dihet sesi kanë funksionuar këto komisione.

z. Ekrem Raka, Unë kryesues kërkoja që të bëhet kompensimi edhe i komisioneve ad hoc, ndërkaq ju nuk e potencuat këtë çështje.

z. Besim Vishi, Nëse bëhen këto ndryshime që u theksuan, unë votoj për, së me të vërtetë ne anëtarët e komisioneve po vijmë me marrë pjesë në komisione komplet me shpenzimet tona.

Nënkryetar i Komunës- Ylber Bajra, Unë nuk po hyjë të baza ligjore, ndërkaq iniciativa për kompensimin e komisioneve të KK ka qenë e kamotshme. Ne jemi me iu dal zot obligimeve si ekzekutiv i komunës, ndërkaq nuk do të thotë së ky Propozim Vendim është i saktë 100%, ndërkaq mbetet në dorën e juaj a e votoni apo jo. Anëtarët nga ekzekutivi nuk u përmend në këtë Propozim Vendim, sepse nuk kompensohen. Në vendim të ceket se do të kompensohen të gjithë komisionet të formuara deri me tani në formë retroaktive, përfshirë edhe komisionet ad hoc.

Kryesuesi i Kuvendit, Të fokusohemi të komisionet të cilat janë formuar deri me tani e të vijmë deri të një zgjedhje. Unë po i potencoj edhe një herë ndryshimet që dolën nga Kuvendi i Komunës në këtë Propozim Vendim:

1. Kërkesa që shuma nga 25 € të bëhet 50 €, për 6 mbledhje (maksimumi) me pagesë për një vit;
2. Pagesa të bëhet vetëm anëtarëve të jashtëm të komisionit (OJQ/shoqëria civile) dhe anëtarëve nga KK;
3. Pagesa të bëhet për të gjitha komisionet, ato që janë me mandat të caktuar brenda afatit të KK dhe komisioneve ad hoc.
4. Komisionet të cilat janë formuar më herët, të bëhet pagesa në formë retroaktive. Për komisionet që formohen tani e tutje nëse nuk mundem me këtë vendim, atëherë çështja e kompensimit të caktohet për secilin vendim me një pikë të veçantë.

Komisioni për persona me aftësi të kufizuara nuk mund të arsyetojmë, pasi që kemi një Komitet konsultativ për persona me aftësi të kufizuara që përcakton detyrat dhe çështjen e kompensimit, ndërkaq për komisionet tjera jemi në rregull.

znj. Arlinda Rakoci-Raka, Edhe Komisioni për emërimin e Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara është themeluar nga kuvendi dhe nuk ka arsye pse të mos kompensohet ky komision.

Kryesuesi i Kuvendit, Atëherë në rregull atëherë, edhe pse e dimë së për çështjen e emërtimit të anëtarëve të Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara ka pasur dy komisione dhe e dimë sesi kanë funksionuar.

Nënkryetari i Komunës, Të gjitha komisionet e kuvendit, qoftë ato me mandat apo ato Ad hoc që janë formuar nga KK e që kanë kryer aktivitet do të kompensohen në formë retroaktive.

z. Besim Vishi, Nëse MAPL e kthen pozitiv këtë vendim, atëherë kush merr përgjegjësi që nuk janë kompensuar komisionet deri me tani.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë me ndryshimet që i theksova, Propozim Vendimin e shtroj në votim për aprovim. Rezultati i votimit ishte njëzëri Për. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi I Komunës mori këtë,

VENDIM

Për kompensimin e komisioneve të formuara nga Kuvendi i Komunës (kompensimi i anëtarëve të jashtëm –OJQ/shoqëria civile dhe anëtarët nga KK) / Lënda: 01Nr. 060/01-18351/20.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu që në ora Kryesuesi i Kuvendit e konstatoj mbledhjen të përfunduar në ora 11: 50 Në fund të mbledhjes ishin prezentë 24 anëtarë.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Makfire Malsiu



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli

Kemal Mërseli

REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës 22 Tetor 2007);

nga Mbledhja e VI –të (Gjashtë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2020, mbajtur me 12 Gusht 2020;

1. Kemal Mërseli.....,
2. Hamid Guri.....,
3. Ahmet Luma,
4. Kadri Krivenjeva,.....,
5. Besim Vishi,.....,
6. Sali Malsiu.....,
7. Lirije Shurdhani.....,
8. Pranverë Loku- Zharku.....,
9. Lirije Luta.....,
10. Vlora Dalloshi.....,
11. Nexhat Loku,
12. Agim Mani.....,
13. Adnan Reka.....,
14. Ekrem Kyçyku.....,
15. Fatijona Kyçyku.....,
16. Kaltrina Tafili,
17. Selim Reka.....,
18. Besnik Salihu,.....,
19. Nazife Krasniqi.....,
20. Arlinda Rakoci-Raka.....,
21. Shemsedin Luzha.....,
22. Albana Troni.....,
23. Afërdita Shehi,..... Dorëheqje
24. Hajredin Luta.....,
25. Hafize Sallahi,
26. Bekim Koxha.....,
27. Ekrem Raka,.....,



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kačanik

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

Kaçanik, 04.09.2020

Për: Anëtarët e Kuvendit/ z. Adnan Reka,
znj. Nazife Krasniqi,
z. Bekim Koxha
z. Besim Vishi

Lënda: PËRGJIGJE

Të nderuar,

Më lejoni t'ju përgjigjem dhe të jap sqarime zyrtare lidhur me pyetjet/kërkesat tuaja, të parashtruar para Kuvendit të Komunës. më datë 12.08.2020, të cilat ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.

z. Adnan Reka

1.Pyetje për DSHPE, Drejtor! A jeni ne dijeni së asnjë ujëmbledhës i reshjeve atmosferike nuk është funksional në rrugën e sapo ndërtuar nga ndërtesa e Postës deri të Ura e Konakut, këtë më së miri e dëshmoi shiu që ra para kësaj jave, për dy ditë me radhë ujërat atmosferik vazhduan të rrjedhin si përrua përmes rrugës dhe si pasojë kemi gërryerje të kubzave dhe deformim të kësaj rruge të sapo rinovuar.

- Ujëmbledhesit e vendosur për ujrat atmosferike nga ndërtesa e Postës deri te Ura e Konakut janë të gjithë funksional. Problemi i rrjedhes se ujit të cilën ju e potenconi ka të bëjë me bllokimin e një segmenti të rrjetit të kanalizimit fekal, përballë Stacionit të Policisë, në të cilin është intervenuar nga KRU "Bifurkacioni" që është përgjegjëse për mirëmbajtjen e rrjeteve të kanalizimit fekal.

Gjithashtu është evidente që gjatë reshjeve të shiut kemi rritje të sasisë së ujit në rrjetet e kanalizimit fekal si rrjedhojë e futjes së ulluqeve të qative të shtëpive në sistem të ujrave fekale gjë që dimenzionimi i gypave nuk e përballon sasinë e madhe të ujit që akumulohet nga qatitë e shtëpive private kur ka reshje të shiut.

2.Për kundër përgjigjeve tuaja me shumë politike sesa përmbajtjesore, rruga nga Shtëpia e Kulturës deri të Xhamia e Dëshmorëve në të dyja anët e lumit është e pa ndriçuar, sigurisht ju po e bëni me qellim për të kursyer buxhetin, por në anën tjetër ju po e instaloni terrin në Komunën tonë, shumë keq!

- Rrjeti i ndriçimit publik përgjatë lumit Nerodime nuk është i përfshirë në masat e reduktimit të kohës së paraparë për ndriçim, por në pjesën nga Shtëpia e Kulturës deri të Xhamia e Dëshmorëve, në të dyja anët e lumit, shumë shpesh kemi veprime vandaliste, duke i dëmtuar trupat ndriçues. Përmes kompanisë së kontraktuar për mirëmbajtjen e ndriçimit publik, intervenojmë në rregullimin dhe rifunksionalizimin tyre gjë e cila ka kosto të vazhdueshme të mirëmbajtjes së tyre.

znj. Nazife Krasniqi

Kam një kërkesë nga banorët e lagjes "Hasan Prishtina" lidhur me mungesën e ndriçimit publik në atë rrugë. Ndriçimi publik në atë rrugë duhet të realizohet, sepse është nevojë dhe kujtoj së kushton shumë realizimi i këtij projekti. Gjithashtu është e nevojshme në atë rrugë të vendoset një barrierë për ndalimin e shpejtësisë, për shkak se kjo rrugë është shumë e frekuentuar

- Ju informoj se në kuadër të planifikimeve të drejtorisë për zgjedhim të rrjetit të ndriçimit publik në zonën urbane, në këtë vit është e planifikuar edhe rruga e lartëcekur dhe implementimi saj do të filloj shumë shpejt.

z.Bekim Koxha, Pyetje për drejtorin e DSHPE. Pse mërgimtarët duhet të paguajnë mbeturinat 20 €, kur dihet se ata nuk qëndrojnë këtu.

- Bazuar në Rregulloren Komunale për Taksa Komunale 01 Nr.02-60/01-4863/20, është përcaktuar tarifa për menaxhimin e mbeturinave dhe atë:

Neni 29 i kësaj rregulloreje e precizon në pikën 1.1.1 ku thuhet "Kategoria e ekonomive familjare jo rezidente paguan ¼ e tarifës vjetore për shërbim të menaxhimit të mbeturinave", tarifë e cila do të implementohet nga muaji shtator i këtij viti.

z.Besim Vishi,

Kam një kërkesë për DSHPE për vendosjen e pengesave në rrugë të shtylla dhe të punësoria në afërsi të shkollës fillore në f. Dubravë. Pengesat mos të bëhen të plastikës, por të jenë me të buta dhe të papërshtatshme. Të energjia elektrike që u potencua së është e dobët në disa fshatra të lagjes Stagovë, projekti ekziston, por nuk është realizuar.

-Drejtoria e Shërbimeve Publike ka të planifikuara lokacione të ndryshme për vendosjen dhe punimin e barrierave (policëve të shtrirë) sidomos në afërsi të institucioneve publik (shkolla, ambulanca, qerdhe etj.) të cilat do të ekzekutohen përmes kompanisë së kontraktuar për vendosjen dhe mirëmbajtjen e sinjalizimit horizontal dhe vertikal dhe asaj për mirëmbajtjen e rrugëve lokale. Në koordinim me ekspertet e kësaj fushe do të vendosim mbi modelin e këtyre barrierave.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin tuaj!

Me respekt,



Ramadhush Osmani

Drejtore i DSHPE-s